



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit  
Ministarstvo obrazovanja, nauke, tehnologije i inovacije  
Ministry of Education, Science, Technology and Innovation*



# Metodat për mësimdhënien me nxënësin në qendër

---



Fakulteti i Edukimit



IHZhA

INSTITUTI PËR HUMANITETIN DHE ZHVILIMIN SOCIAL



# Metodat për mësimdhënien me nxënësin në qendër

---

# Falënderimet

- @ Ky doracak është një përshtatje e Doracakut të Strategjive të Mësimnxënies Aktive, i hartuar dhe zhvilluar në një punë bashkëpunuese nga Drejtoria e Përgjithshme e Kurrikulës (DPK) e Ministrisë Afgane të Arsimit (MA), UNICEF-it në Afganistan, dhe Zyrës së UNESCO-s në Afganistan, botuar në vitin 2019. Ne dëshirojmë të shprehim respektin dhe mirënjohjen tonë më të lartë për punën e tyre për të mirën e shumë nxënësve dhe mësimeve.
- @ Ky material është zhvilluar me mbështetjen e Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH në emër të Qeverisë Gjermane.

Teksti origjinal në gjuhën Shqipe [2020]

E drejta për përdorim, riprodhim dhe redaktim i është bartur Universitetit të Prishtinës - Fakultetit të Edukimit dhe Instituti për Hulumtime dhe Zhvillim të Arsimit (2023)

Përmbajtja e tekstit origjinal është përgjegjësi e autorëve dhe jo domosdoshmërisht pasqyron opinionin zyrtar të Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH apo të Qeverisë Gjermane.

## Autorë:

Dr. Christian Helmchen

## Dizajni dhe faqesja nga:

Envinion, Prishtinë

## Foto:

GIZ Kosova

Prishtinë, Tetor 2020


















german  
cooperation  
DEUTSCHE ZUSAMMENARBEIT

Implemented by

**giz** Deutsche Gesellschaft  
für Internationale  
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

# Tabela e përmbajtjes

Për kë është ky Doracak?	4
Çka janë strategjitë e mësimnxënies aktive?	4
Pse janë të rëndësishme strategjitë e mësimnxënies aktive?	4
Udhëzimet praktike	5
Taksonomia e Bloom-it	5
 Mendo – Krijo çift – Ndaj me të tjerët	6
 Gjej dikë i cili...	7
 Shkopinj për bisedë	8
 4 Këndet	9
 Shtroja e të menduarit	10
 Rreshtimi	11
 Drejto dhe Dikto	12
 Enigma	13
 Stacioni mësimor	14
 Kartela e pyetjeve dhe përgjigjeve të shpejta	15
 Tabela e zgjedhjes	16
 PMI	17
 Posterat dhe Ecje në galeri	18
 2 yje dhe një dëshirë	19
 Fakti apo Mendimi	20
Shablloni i Zbrazët i Metodës	21
Shënimet	22

# Hyrje

## Për kë është ky Doracak?

Ky doracak është krijuar për të mbështetur mësimdhënësit në përpjekjet e tyre të vazhdueshme për të përmirësuar praktikën e përditshme në klasë. Ai siguron ide dhe sugjerime për mësimdhënësit në mënyrë që t'i vendosin nxënësit e tyre në qendër të procesit mësimor. Ai është gjithashtu i dobishëm për hartuesit e kurrikulës të cilët kanë një rëndësi jetësore kur bëhet fjalë për të lënë vend për forma të ndryshme dhe bashkëkohore të mësimdhënies.

## Çka janë strategjitë e mësimnxënies aktive?

Strategjitë e mësimnxënies aktive jo vetëm që përmirësojnë rezultatet e të nxëniet dhe kohezionin social në klasë, ato gjithashtu nxisin aftësitë autonome të të nxëniet, aftësinë për të punuar në ekipe dhe sigurojnë një shumëllojshmëri ndaj rutinës së përditshme mësimore, duke rezultuar në motivim më të lartë. Shkurtimisht, strategjitë e mësimnxënies aktive:

- angazhojnë nxënësit në mësim
- ndihmojnë nxënësit që të marrin përgjegjësi për proceset e tyre të të nxëniet
- ndihmojnë në ndërtimin e kompetencave për të mësuarit gjatë gjithë jetës
- ndihmojnë nxënësit që të mësojnë thellësisht
- nxisin aftësitë e punës ekipore
- rrënjësojnë dhe afirmojnë një larmi kompetencash përveç atyre të lëndës

## Pse janë të rëndësishme strategjitë e mësimnxënies aktive?

Në mjedisin e sotëm jashtëzakonisht dinamik të punës, nxënësit kanë nevojë për shumë më tepër sesa njohuri faktike. Epoka e informatave jo vetëm që ofron një larmi të madhe mundësish, por gjithashtu vjen me sfida të shumta që njerëzit duhet t'i trajtojnë me kompetencë për të qenë të suksesshëm. Strategjitë e mësimnxënies aktive u ndihmojnë nxënësve të mësojnë si t'i zbatojnë njohuritë e tyre, të marrin informata, t'i analizojnë problemet, të përdorin kreativitetin e tyre dhe të vlerësojnë vetë përparimin e tyre, duke u mundësuar kështu që të vazhdojnë të mësojnë vetë, shumë pasi të kenë mbaruar karrierën e tyre në shkollë.

Në fund, strategjitë e mësimnxënies aktive gjithashtu ju ndihmojnë të shijoni mësimdhënien më shumë se kurrë më parë. Ato ju ofrojnë mundësinë për të adresuar nevojat individuale të nxënësve ndërsa janë duke punuar së bashku. Ju do të evoluoni nga një mësimdhënës në shoqërues të tyre mësimor. Për shkak të faktit se materialet përgatiten para orës mësimore, përdorimi i strategjive të mësimnxënies aktive gjithashtu ju japin mundësinë të bëni një hap prapa dhe të vëzhgoni orën tuaj mësimore.

... dhe sigurisht, me përdorimin e strategjive të mësimnxënies aktive, mësimnxëniet janë më argëtuese për të gjithë!

## Udhëzimet praktike


Ky doracak përmban një strategji të mësimnxënies aktive për faqe. Për secilën, do t'ju jepen informatat e mëposhtme:

- Një përshkrimi i shkurtër
- Një shpjegim i qëllimit
- Një udhëzim hap pas hapi
- Idetë për zgjerimin e metodës

Ky doracak ofron vetëm një përqindje të vogël të shumë strategjive të mësimnxënies aktive që ekzistojnë. Ju mund të gjeni një numër të madh të tyre në internet. Ne gjithashtu dëshirojmë t'ju inkurajojmë që t'i ndani përvojat tuaja - të mira dhe të këqija - me kolegët tuaj dhe t'u siguroni atyre materialet që i keni hartuar.

## Taksonomia e Blunit (Bloom-it)

Një nga përparësitë e shumta të strategjive të mësimnxënies aktive është se nxit aftësitë e të menduarit të një niveli më të lartë. Në Taksonominë e Bloom-it mund të shihni nivele të ndryshme të kompetencës, të cilat variojnë nga memorizimi dhe mbajtja mend e fakteve deri te aftësia e kombinimit dhe përdorimit të të gjitha njohurive për të krijuar diçka të re. Për secilën metodë do t'ju jepen informata se cilat aftësi dhe cilat kompetenca jetësore po zhvillohen.



# Mendo – Krijë çift – Ndaj me të tjerët

## PËRSHKRIMI:

Strategjia për dy nxënës të bashkuar dhe t'i ndajnë mendimet e tyre me një grup më të madh.

## QËLLIMI:

Kjo strategji i shtyn nxënësit që të reflektojnë mbi një çështje ose problem dhe më pas të ndajnë mendimin e tyre me të tjerët. Nxënësit zgjerojnë të kuptuarit e tyre për një temë dhe përfitojnë nga ndarja e ideve me të tjerët. Ajo gjithashtu:

- U ndihmon nxënësve që të përqendrojnë mendimet e tyre në një pyetje, problem ose çështje
- Inkurajon nxënësit që kanë më pak vetëbesim për të ndarë punën e tyre me një partner



### Grupimet:

Çifti, grupi më i madh, e gjithë klasa



### Niveli i Klasës:

Cilido



### Koha:

10 – 15 minuta



Kur prezantohen më së miri në njësinë mësimore:

Në çfarëdo kohe



## SHTESË:

Përziej me të tjerët – Krijë çift – Ndaj me të tjerët (<https://www.weareteachers.com/5-fun-alternatives-to-think-pair-share/>). Nxënësit përzihen nëpër klasë me muzikë dhe gjejnë një partner për të biseduar kur muzika ndalet.

## UDHËZIMET

- 1 Mësimdhënësi i paraqet klasës një pyetje ose formulim mbi një problem ose çështje.
- 2 Nxënësit kalojnë 1 – 2 minuta kohë duke menduar individualisht për përgjigjet e tyre ndaj pyetjes ose formulimit.
- 3 Nxënësit ndajnë përgjigjet e tyre me një partner. Nxënësit duhet të jenë të qartë në mendimet, shpjegimet dhe shembujt e tyre.
- 4 Mësimdhënësi fton çiftet të ndajnë përgjigjet e tyre me një grup më të madh ose të gjithë klasën.

## KOMPETENCAT DHE NËN-KOMPETENCAT E PËRKRAHURA

### Taksonomia e Bloom-it

<input type="radio"/> Mbajtja mend	Listo, recito, përshkruaj, përkufizo, emërto, përrputh, cito, kujto, identifiko, etiketo, njoh
<input type="radio"/> Të kuptuarit	Përshkruaj, shpjego, parafrazo, rideklaro, jep shembuj, përmbledh, krahaso me të kundërtën, interpreto, diskuto
<input type="radio"/> Zbatimi	Llogarit, parashiko, apliko, zgjidh, ilustrto, përdor, demonstro, përcakto, modelo, realizo, paraqit
<input checked="" type="radio"/> Analizimi	Klasifiko, zbërthe, kategorizo, analizo, krijo diagram, kritikto, thjeshtëso, bëj asociim
<input type="radio"/> Vlerësimi	Zgjedh, mbështet, ndërlihdh, përcakto, mbrojtë, gjyko, vlerëso, krahaso, krahaso me të kundërtën, argumento, arsyeto, mbështet, bind, përzgjedh, vlerëso
<input type="radio"/> Krijimi	Dizajno, formulo, ndërto, zbullo, krijo, kompono, nxjerr kuptim, modifiko, zhvillo

### Kompetencat

<input checked="" type="checkbox"/> Mendimi kritik	Nxjerrja e përfundimit dhe vlerësimi
<input type="checkbox"/> Mendimi kreativ	
<input type="checkbox"/> Zgjidhja e problemeve	
<input checked="" type="checkbox"/> Komunikimi	Të dëgjuarit dhe të folurit aktiv
<input type="checkbox"/> Bashkëveprimi	
<input type="checkbox"/> Vet-menaxhimi	



# Gjej dikë i cili...

## PËRSHKRIMI:

Kjo strategji përfshin nxënësit që u bëjnë nxënësve të tjerë pyetje që të përipiqen të gjejnë dikë në klasë që përputhet me përshkrimin ose di informata të caktuara.

## QËLLIMI:

Për të praktikuar fjalorin e ri, për të aktivizuar njohuritë paraprake, ose për të rishikuar konceptet. Përdorni "Gjej dikë i cili...":

- Në fillim të njësisë mësimore për të rishikuar ose prezantuar lëndën
- Si një përmbledhje për një njësi ose kapitull
- Për praktikimin e përdorimit të fjalorit në një njësi studimi



### Grupimet:

Çifti, grupi më i madh, e gjithë klasa



### Niveli i Klasës:

Cilido



### Koha:

10 – 15 minuta



### Kur prezantohen më së miri në njësinë mësimore:

Në çfarëdo kohe



## SHITESË:

Kjo gjithashtu mund të përdoret si i një strategji "e njohjes" për të ndërtuar komunitetin dhe për të përkrahur kohezionin social.

## UDHËZIMET

- 1 Mësimdhënësi përgatit 10 formulime "Gjej dikë i cili" dhe u jep një fletë pune me formulime secilit nxënës.
- 2 Mësimdhënësi krijon një shumëllojshmëri formulimesh në mënyrë që të jetë e lehtë për të gjetur ndonjë nxënës me disa karakteristika, por jo aq e lehtë për të gjetur të tjerët.
- 3 Nxënësit i bëjnë pyetje njëri-tjetrit për të gjetur dikë që përputhet me formulimin në fletën e punës.
- 4 Nxënësit pyesin të gjithë në klasë derisa të gjejnë dikë që e ka atë karakteristika, ose mund t'i përgjigjen pyetjes. Ata shkruajnë emrin e atij nxënësi në fletën e tyre të punës dhe kalojnë në pyetjen tjetër.
- 5 Është e rëndësishme që emri i nxënësit të shkruhet vetëm një herë.

## KOMPETENCAT DHE NËN-KOMPETENCAT E PËRKRAHURA

### Taksonomia e Bloom-it

- Mbajtja mend** ▶ Listo, recito, përshkruaj, përkufizo, emërto, përputh, cito, kujto, identifikoj, etiketo, njoh
- Të kuptuarit** ▶ Përshkruaj, shpjego, parafrazo, rideklaro, jep shembuj, përmbledh, krahaso me të kundërtën, interpreto, diskuto
- Zbatimi** ▶ Llogarit, parashiko, apliko, zgjidh, ilustrto, përdor, demonstro, përcakto, modelo, realizo, paraqit
- Analizimi** ▶ Klasifikoj, zbërthe, kategorizoj, analizo, krijo diagram, kritikoj, thjeshtëso, bëj asociim
- Vlerësimi** ▶ Zgjedh, mbështet, ndërlikoj, përcaktoj, mbrojt, gjyko, vlerëso, krahaso, krahaso me të kundërtën, argumentoj, arsyeto, mbështet, bind, përzgjedh, vlerëso
- Krijimi** ▶ Dizajno, formulo, ndërtoj, zbuloj, krijo, komponoj, nxjerr kuptim, modifikoj, zhvillo

### Kompetencat

- Mendimi kritik** ▶ Mbledh, analizo dhe vlerëso kredibilitetin e informatave/nxjerr përfundimin dhe vlerësimin
- Mendimi kreativ** ▶
- Zgjidhja e problemeve** ▶
- Komunikimi** ▶ Të dëgjuarit dhe të folurit aktiv/shkathtësitë e komunikimit joverbal
- Bashkëveprimi** ▶
- Vet-menaxhimi** ▶

# Shkopinj për bisedë

## PËRSHKRIMI:

Kjo strategji përfshin që nxënësit të veprojnë me radhë, të dëgjojnë dhe të ofrojnë mundësi për të gjithë që të flasin.

## QËLLIMI:

Për nxënësit që të:

- U jepet të gjithëve në grup një shans e barabartë për të folur dhe për të ndarë mendimet e tyre
- Mendoni me kujdes se çfarë do të donin të thoshin dhe si ta shprehin më së miri atë
- Praktikoni aftësitë e të dëgjuarit aktiv
- Shtoni në mënyrë konstruktive ndaj asaj që thotë dikush



### Grupimet:

Grupe me nga 4 persona



### Niveli i Klasës:

Cilido



### Koha:

10 – 15 minuta



### Kur prezantohen më së miri në njësinë mësimore:

Në mes



## SHTESË:

Për të theksuar ndërrimin e radhës mund të përdoret një top në vend të shkopinjve, ku nxënësit e gjuajnë topin tek folësi i radhës pasi ata të kenë mbaruar së foluri.

## UDHËZIMET

- 1 Secili nxënës merr tre shkopinj.
- 2 Nxënësit fillojnë të diskutojnë ndonjë çështje.
- 3 Çdoherë që flet nxënësi, ata japin një nga shkopinjët e tyre.
- 4 Pasi t'i kenë përdorur tre shkopinj, nxënësi nuk mund të flet më.
- 5 Mësimdhënësi apo nxënësi i përzgjedhur shkruan pikat e rëndësishme në dërrasë të zezë apo tabelë me letra të mëdha gjatë diskutimit.

## KOMPETENCAT DHE NËN-KOMPETENCAT E PËRKRAHURA

### Taksonomia e Bloom-it

<input type="radio"/> Mbajtja mend	Listo, recito, përshkruaj, përkufizo, emërto, përrputh, cito, kujto, identifiko, etiketo, njoh
<input type="radio"/> Të kuptuarit	Përshkruaj, shpjego, parafrazo, rideklaro, jep shembuj, përmbledh, krahaso me të kundërtën, interpreto, diskuto
<input type="radio"/> Zbatimi	Llogarit, parashiko, apliko, zgjidh, ilustrto, përdor, demonstro, përcakto, modelo, realizo, paraqit
<input type="radio"/> Analizimi	Klasifiko, zbërthe, kategorizo, analizo, krijo diagram, kritiko, thjeshtëso, bëj asociim
<input checked="" type="radio"/> Vlerësimi	Zgjedh, mbështet, ndërlidh, përcakto, mbrojtë, gjyko, vlerëso, krahaso, krahaso me të kundërtën, argumento, arsyeto, mbështet, bind, përzgjedh, vlerëso
<input type="radio"/> Krijimi	Dizajno, formulo, ndërto, zbullo, krijo, kompono, nxjerr kuptim, modifiko, zhvillo

### Kompetencat

<input checked="" type="checkbox"/> Mendimi kritik	Mbledh, analizo dhe vlerëso kredibilitetin e informatave/nxirr përfundimin dhe vlerësimin
<input type="checkbox"/> Mendimi kreativ	
<input type="checkbox"/> Zgjidhja e problemeve	
<input checked="" type="checkbox"/> Komunikimi	Të dëgjuarit dhe të folurit aktiv/shkathtësitë e komunikimit joverbal
<input type="checkbox"/> Bashkëveprimi	
<input type="checkbox"/> Vet-menaxhimi	

# 4 Këndet

## PËRSHKRIMI:

Nxënësit marrin parasysh disa çështje, ide ose faktorë që lidhen me një çështje dhe ndajnë mendimin e tyre duke shkuar në një nga katër këndet e caktuara.

## QËLLIMI:

- Angazhimi i nxënësve për mësimnxënien aktive
- Rritja e interesimit të nxënësve rreth temës
- Të menduarit kreativ të nxënësve dhe ndarja e mendimit të tyre rreth ndonjë çështjeje



### Grupimet:

E gjithë klasa



### Niveli i Klasës:

Cilido



### Koha:

10 – 15 minuta



### Kur prezantohen më së miri në njësinë mësimore:

Në fillim apo në fund



## SHTESË:

Opsionale: kërkoni nga ata që t'i vizitojnë këndet tjera për të parë se çka kanë menduar të tjerët lidhur me idetë e tyre si dhe provat që ata i kanë sjell. Nxënësit i evidentojnë idetë dhe mendimet e tyre në mënyrë të shkruar.

## UDHËZIMET

- 1 Mësimdhënësi ndan një formulim për nxënësit që ta marrin parasysh. Mësimdhënësi etiketoi çdo kënd të klasës me zgjedhje në lidhje me çështjen (p.sh. pajtohem plotësisht, pajtohem, nuk pajtohem, nuk pajtohem aspak)
- 2 Nxënësit shkojnë në këndin të klasës që e ka formulimin me të cilin ata pajtohen më së shumti. Nëse mendojnë se më shumë se një përgjigje është e saktë, ata zgjedhin këndin me të cilin pajtohen plotësisht.
- 3 Nxënësit ndajnë mendimin e tyre dhe të çiftit në këndin ku ndodhen.

## KOMPETENCAT DHE NËN-KOMPETENCAT E PËRKRAHURA

### Taksonomia e Bloom-it

- Mbajtja mend** ▶ Listo, recito, përshkruaj, përkufizo, emërto, përputh, cito, kujto, identifikoj, etiketo, njoh
- Të kuptuarit** ▶ Përshkruaj, shpjego, parafrazo, rideklaro, jep shembuj, përmbledh, krahaso me të kundërtën, interpreto, diskuto
- Zbatimi** ▶ Llogarit, parashiko, apliko, zgjidh, ilustron, përdor, demonstro, përcakto, modelo, realizo, paraqit
- Analizimi** ▶ Klasifiko, zbërthe, kategorizo, analizo, krijo diagram, kritikoj, thjeshtëso, bëj asociim
- Vlerësimi** ▶ Zgjedh, mbështet, ndërlihd, përcakto, mbrojtë, gjyko, vlerëso, krahaso, krahaso me të kundërtën, argumento, arsyeto, mbështet, bind, përzgjedh, vlerëso
- Krijimi** ▶ Dizajno, formulo, ndërto, zbuloj, krijo, kompono, nxjerr kuptim, modifikoj, zhvillo

### Kompetencat

- Mendimi kritik** ▶ Bëni pyetje kritike / Mblidhni, analizoni dhe vlerësoni besueshmërinë e informatave / nxirrni përfundimin dhe vlerësimin
- Mendimi kreativ** ▶
- Zgjidhja e problemeve** ▶
- Komunikimi** ▶ Të dëgjuarit dhe të folurit aktiv
- Bashkëveprimi** ▶
- Vet-menaxhimi** ▶

# Shtroja e të menduarit

## PËRSHKRIMI:

Kjo është një strategji ku nxënësit në grup së pari mendojnë për një koncept, shkruajnë idetë e tyre individualisht, dhe pastaj diskutojnë dhe vendosin për një përkufizim ose vendim të përbashkët dhe e shkruajnë atë për ta ndarë me të gjithë klasën.

## QËLLIMI:

- Që nxënësit të mendojnë në mënyrë kritike rreth koncepteve
- Që nxënësit të mund t'i shprehin mendimet e tyre me shkrim
- Që nxënësit të mund të gjejnë bazë të përbashkët dhe t'i sintetizojnë idetë e tyre për të marr vendimet



### Grupimet:

Grupe individuale me nga 4 persona



### Niveli i Klasës:

Cilido



### Koha:

10 - 15 minuta



### Kur prezantohen më së miri në njësine mësimore:

Çfarëdo kohe



## SHTESË:

Të gjithë nxënësit kontribuojnë me idetë e tyre lidhur me procesin apo tregimin dhe i kombinojnë idetë në mesë.

## UDHËZIMET

- 1 Nxënësit marrin një shtrojë të madhe për menduar (madhësia A3) e cila ka një rreth në mes dhe katër vija të vizatuara nga katër cepat të cilat përfundojnë përreth rrethit. Kjo bëhet për të ndarë letrenë në pesë pjesë, një në mes dhe katër pjesë të tjera përreth rrethit.
- 2 Nxënësit mendojnë për një koncept dhe individualisht shkruajnë një përkufizim ose idetë e tyre lidhur me konceptin. Ata shkruajnë në pjesën e tyre të shtrojës.
- 3 Nxënësit diskutojnë dhe vendosin për një përkufizim ose ide të përbashkët dhe shkruajnë idetë e tyre të përbashkëta në rrethin në mes të shtrojës.
- 4 Nxënësit i ndajnë idetë e tyre.

## KOMPETENCAT DHE NËN-KOMPETENCAT E PËRKRAHURA

### Taksonomia e Bloom-it

<input type="radio"/> Mbajtja mend	Listo, recito, përshkruaj, përkufizo, emërto, përputh, cito, kujto, identifiko, etiketo, njoh
<input type="radio"/> Të kuptuarit	Përshkruaj, shpjego, parafrazo, rideklaro, jep shembuj, përmbledh, krahaso me të kundërtën, interpreto, diskuto
<input type="radio"/> Zbatimi	Llogarit, parashiko, apliko, zgjidh, ilustrto, përdor, demonstro, përcakto, modelo, realizo, paraqit
<input type="radio"/> Analizimi	Klasifiko, zbërthe, kategorizo, analizo, krijo diagram, kritiko, thjeshtëso, bëj asociim
<input checked="" type="checkbox"/> Vlerësimi	Zgjedh, mbështet, ndërlidh, përcakto, mbrojtë, gjyko, vlerëso, krahaso, krahaso me të kundërtën, argumento, arsyeto, mbështet, bind, përzgjedh, vlerëso
<input type="radio"/> Krijimi	Dizajno, formulo, ndërto, zbullo, krijo, kompono, nxjerr kuptim, modifiko, zhvillo

### Kompetencat

<input checked="" type="checkbox"/> Mendimi kritik	Bëni pyetje kritike / Mblidhni, analizoni dhe vlerësoni besueshmërinë e informatave / nxirrni përfundimin dhe vlerësimin
<input type="radio"/> Mendimi kreativ	
<input type="radio"/> Zgjidhja e problemeve	
<input checked="" type="checkbox"/> Komunikimi	Të dëgjuarit dhe të folurit aktiv / Negocimi dhe ndikimi
<input type="radio"/> Bashkëveprimi	
<input type="radio"/> Vet-menaxhimi	

# Rreshtimi

## PËRSHKRIMI:

Nxënësit rreshtohen sipas formulimit të dhënë nga mësuesi ose një nxënës tjetër. Mund të jetë sipas gjatësisë, moshës, emrit sipas rendit alfabetik, ose vlerësimi për një çështje (nga 1 - 10). Rreshti mund të ndahet në gjysmë për të formuar çifte të cilët shikojnë njëri-tjetrin përballë dhe shpjegojnë vlerësimin e tyre. Ose rreshti mund të ndahet me nga katër persona për të formuar grupe të vogla për një strategji tjetër të grupit.

## QËLLIMI:

- Nxënësit ndajnë idetë e tyre lidhur me temën apo konceptin
- Vlerësimi formues për mësuesin dhe nxënësit lidhur me një mori mendimesh në klasë
- Ndarja e nxënësve në grupe.



**Grupimet:**  
E gjithë klasa



**Niveli i Klasës:**  
Cilido



**Koha:**  
10 minuta



**Kur prezantohen më së miri në njësinë mësimore:**  
Në çfarëdo kohe



## SHTESË:

Ky aktivitet mund të përdoret për t'i dhënë energji nxënësve gjatë orës mësimore (p.sh. nëse duken të demotivuar). Është një aktivitet i shpejtë dhe i lehtë për t'i riangazhuar nxënësit.

## UDHËZIMET

- 1 Mësuesi ofron një formulim për të gjithë nxënësit që ata të japin mendimin e tyre.
- 2 Nxënësit formojnë një rresht për të treguar mendimin e tyre lidhur me formulimin.
- 3 Mësuesi ndan rreshtin në dy dhe nxënësit nga secili skaj i rreshtit lëvizin për të qëndruar përballë me njëri-tjetrin. Nxënësit diskutojnë mendimin e tyre me partnerin e tyre.
- 4 Përndryshe, mësuesi e ndan rreshtin në grupe me nga katër persona për një strategji tjetër të grupit.

## KOMPETENCAT DHE NËN-KOMPETENCAT E PËRKRAHURA

### Taksonomia e Bloom-it

- Mbajtja mend** ▶ Listo, recito, përshkruaj, përkufizo, emërto, përputh, cito, kujto, identifikoj, etiketo, njoh
- Të kuptuarit** ▶ Përshkruaj, shpjego, parafrazo, rideklaro, jep shembuj, përmbledh, krahaso me të kundërtën, interpreto, diskuto
- Zbatimi** ▶ Llogarit, parashiko, apliko, zgjidh, ilustrto, përdor, demonstro, përcakto, modelo, realizo, paraqit
- Analizimi** ▶ Klasifikoj, zërbër, kategorizoj, analizo, krijo diagram, kritikoj, thjeshtëso, bëj asociacione
- Vlerësimi** ▶ Zgjedh, mbështet, ndërlidh, përcakto, mbrojtë, gjyko, vlerëso, krahaso, krahaso me të kundërtën, argumentoj, arsyeto, mbështet, bind, përzgjedh, vlerëso
- Krijimi** ▶ Dizajno, formulo, ndërto, zbuloj, krijo, kompono, nxjerr kuptim, modifikoj, zhvillo

### Kompetencat

- Mendimi kritik** ▶ Bëni pyetje kritike / nxirrni përfundimin dhe vlerësimin
- Mendimi kreativ** ▶
- Zgjidhja e problemeve** ▶
- Komunikimi** ▶ Të dëgjuarit dhe të folurit aktiv
- Bashkëveprimi** ▶
- Vet-menaxhimi** ▶

# Drejto dhe Dikto

## PËRSHKRIMI:

Nxënësit mbledhin informata nga postera, tekste, fotografi nga klasa dhe ia diktojnë një grupi të vogël.

## QËLLIMI:

Kjo është një strategji e cila:

- Angazhon dhe motivon nxënësit që të mësojnë lëndën në një mënyrë interesante
- Ua mundëson nxënësve që të praktikojnë të folurit, të dëgjuarit, të shkruarit, të kujtuarit dhe të përmbledhurit
- Inkurajon nxënësit që të punojnë në bashkëpunim në grupe.



**Grupimet:**  
E gjithë klasa



**Niveli i Klasës:**  
4+



**Koha:**  
20 – 30 minuta



**Kur prezantohen më së miri në njësinë mësimore:**  
Në mes



## SHTESË:

- 1 Nxënësit korrigjojnë punën e njëri tjetrit.
- 2 Nxënësit krijojnë pyetje kuiz për pjesët e shkëputura/fjalitë me përgjigjet për t'i këmbyer dhe kompletuar me një grup tjetër.

## UDHËZIMET

- 1 Mësimdhënësi zgjedh një fragment të shkurtër, fjali ose postera, bën disa kopje dhe i vendos ato përreth mureve të klasës ose në tavolinën e përparme. Duhet të ketë një hapësirë në klasë ose korridor për këtë strategji.
- 2 Nxënësit në secilin grup ecin me radhë (ose vrapojnë) për të lexuar fragmentin ose fjalitë në mur. Ata mbajnë mend disa nga fragmentet ose njërën nga fjalitë dhe ecin (ose vrapojnë) përsëri prapa te grupi.
- 3 Nxënësi dikton me zë të ulët atë që ka mbajtur mend dhe grupi e shkruan. Pastaj një tjetër nxënës shkon dhe lexon disa nga fragmentet ose një fjali tjetër.
- 4 Nxënësit e bëjnë me radhë vrapimin dhe diktimin e pjesëve të fragmentit ose fjalive derisa t'i kenë shkruar të gjitha.
- 5 Grupi fitues është ekipi që përfundon i pari, edhe pse duhet të kontrollojnë për gabimet. Nëse ka gabime, nxënësit duhet të vazhdojnë të ecin për të kontrolluar!

## KOMPETENCAT DHE NËN-KOMPETENCAT E PËRKRAHURA

### Taksonomia e Bloom-it

- Mbajtja mend** Listo, recito, përshkruaj, përkufizo, emërto, përputh, cito, kujto, identifikoj, etiketo, njoh
- Të kuptuarit** Përshkruaj, shpjego, parafrazo, rideklaro, jep shembuj, përmbledh, krahaso me të kundërtën, interpreto, diskuto
- Zbatimi** Llogarit, parashiko, apliko, zgjidh, ilustrto, përdor, demonstro, përcakto, modelo, realizo, paraqit
- Analizimi** Klasifiko, zërthe, kategorizo, analizo, krijo diagram, kritiko, thjeshtëso, bëj asocim
- Vlerësimi** Zgjedh, mbështet, ndërlihd, përcakto, mbrojtë, gjyko, vlerëso, krahaso, krahaso me të kundërtën, argumento, arsyeto, mbështet, bind, përzgjedh, vlerëso
- Krijimi** Dizajno, formulo, ndërto, zbuloj, krijo, kompono, nxjerr kuptim, modifikoj, zhvillo

### Kompetencat

- Mendimi kritik**
- Mendimi kreativ**
- Zgjidhja e problemeve**
- Komunikimi** Të dëgjuarit dhe të folurit aktiv
- Bashkëveprimi** Pjesëmarrja aktive në punë grupore / përcaktimi dhe ndjekja e rregullave dhe procedurave grupore
- Vet-menaxhimi**

# Enigma

## PËRSHKRIMI:

Një strategji ku nxënësit kanë informata të ndryshme dhe duhet të punojnë së bashku për të përfunduar një detyrë duke ndarë informatat e tyre.

## QËLLIMI:

Kjo strategji inkurajon nxënësit që të:

- Komunikojnë qartë dhe me vetëbesim me nxënësit e tjerë.
- Mendojnë në mënyrë kritike se si të sintetizojnë informata dhe të krijojnë informata të reja.
- Punojnë në bashkëpunim për të përfunduar detyrën duke përdorur informata individuale që kanë.



### Grupimet:

Grupe me nga 4 persona



### Niveli i Klasës:

4+



### Koha:

30 – 60 minuta



### Kur prezantohen më së miri në njësinë mësimore:

Në mes



## SHTESË:

Secilit grup i jepet një pjesë e tekstit të madh. Nxënësit lexojnë dhe e përmbledhin pjesën e tyre të tekstit dhe pastaj duhet të identifikojnë se lidhur me çka ka të bëjë teksti.

## UDHËZIMET

- 1 Mësimdhënësi zgjedh pjesë të ndryshme të informatave për të njëjtën temë, ose e pret një tekst në katër pjesë (informata mund të jetë një kombinim i figurave dhe tekstit).
- 2 Mësimdhënësi i ndan nxënësit në grupe me nga katër veta dhe secili nxënës ka një informatë tjetër.
- 3 Mësimdhënësi përgatit një detyrë dhe nxënësit duhet të kontribuojnë me idetë nga informatat e tyre në mënyrë që ta zgjidhin detyrën (kjo mund të jetë vendosja e fotografive në mënyrën e duhur për të përcaktuar një proces, kombinimi i informatave për të bërë një tregim, ndërtimi i një ekuacioni matematikor nga informata të ndryshme).
- 4 Nxënësit nuk duhet t'i tregojnë njëri-tjetrit informatat e tyre, por duhet të komunikojnë herët me informata.
- 5 Kur nxënësit të kenë përfunduar detyrën ata i tregojnë njëri-tjetrit informatat e tyre për të kontrolluar punën e tyre.

## KOMPETENCAT DHE NËN-KOMPETENCAT E PËRKRAHURA

### Taksonomia e Bloom-it

- Mbajtja mend** Listo, recito, përshkruaj, përkufizo, emërto, përputh, cito, kujto, identifikoj, etiketo, njoh
- Të kuptuarit** Përshkruaj, shpjego, parafrazo, rideklaro, jep shembuj, përmbledh, krahaso me të kundërtën, interpreto, diskuto
- Zbatimi** Llogarit, parashiko, apliko, zgjidh, ilustru, përdor, demonstro, përcakto, modelo, realizo, paraqit
- Analizimi** Klasifiko, zbërthe, kategorizo, analizo, krijo diagram, kritiko, thjeshtëso, bëj asocim
- Vlerësimi** Zgjedh, mbështet, ndërlidh, përcakto, mbroj, gjyko, vlerëso, krahaso, krahaso me të kundërtën, argumento, arsyeto, mbështet, bind, përzgjedh, vlerëso
- Krijimi** Dizajno, formulo, ndërto, zbulo, krijo, kompono, nxjerr kuptim, modifikoj, zhvillo

### Kompetencat

- Mendimi kritik** Bëni pyetje kritike / Mblidhni, analizoni dhe vlerësoni besueshmërinë e informatave / nxirri përfundimin dhe vlerësimin
- Mendimi kreativ**
- Zgjidhja e problemeve** Identifikimi dhe analizimi i një problemi/krahasimi, krahasimi me kontrast, klasifikimi, vlerësimi i informatës/marrja e vendimeve për zgjidhjen që duhet aplikuar
- Komunikimi** Të dëgjuarit dhe të folurit aktiv
- Bashkëpunimi** Pjesëmarrja aktive në punën në grup/vendosja dhe ndjekja e rregullave dhe procedurave të grupit/ndarja e informatave dhe burimeve/vlerësimi i punës në grup
- Vet-menaxhimi**

# Stacioni mësimor

## PËRSHKRIMI:

Stacionet mësimore janë hapësira ku sigurohen aktivitete të ndryshme rreth një ideje ose teme të madhe. 5 deri në 6 stacione mësimore vendosen në klasë. Ato mund të vendosen përkohësisht ose në mënyrë të përhershme. Ato përdoren për të prezantuar një përmbajtje në një mënyrë interesante në mënyrë që nxënësit të kenë mundësi të marrin informata në mënyrë të pavarur ose në grupe të vogla. Aktivitetet në stacionet mësimore mund të përfshijnë dëgjim, lexim, shkencë, pikturim ose muzikë.

## QËLLIMI:

Stacionet mësimore nxisin të menduarit kritik, zgjidhjen e problemeve dhe të mësuarit në bashkëveprim. Ata promovojnë eksplorimin, ndërveprimin dhe kërkimin e nxënësve.



### Grupimet:

Grupe me nga 4 persona



### Niveli i Klasës:

4+




### Koha:

30 - 60 minuta



### Kur prezantohen më së miri në njësinë mësimore:

Në mes



## SHTESË:

Nxënësit krijojnë stacione të punës për nxënësit e tjerë duke menduar për detyrën apo strategjinë duke përdorur përmbajtjen e parashtuar në njësinë mësimore që janë duke vijuar nxënësit e tjerë.

## UDHËZIMET

- 1 Para mësimit, mësimpldhënësi krijon një numër detyrash të ndryshme që lidhen me përmbajtjen e njësisë mësimore. Këto mund të jenë materiale kërkimore për një temë, një detyrë për zgjidhjen e problemeve, pyetje të ndryshme të matematikës etj. Aktivitetet mund të përfshijnë nivele të diferencuara. Detyrat duhet të jenë të hapura.
- 2 Në fillim të njësisë mësimore, mësimpldhënësi ua prezanton nxënësve stacionet mësimore dhe detyrat e ndryshme. Mësimpldhënësi gjithashtu jep udhëzime për kohën në secilin stacion dhe mënyrën se si nxënësit përzgjedhin detyrat. P.sh., nxënësit mund të kenë 10 minuta në secilin stacion ose përzgjedhin vetëm një stacion ku do të punojnë.
- 3 Nxënësit regjistrojnë atë punë ose ndajnë detyrat që kanë përfunduar me nxënësit e tjerë.
- 4 Detyrat e stacionit mësimor mund dhe vazhdojnë të jenë në një numër të njësisive mësimore.

## KOMPETENCAT DHE NËN-KOMPETENCAT E PËRKRAHURA

### Taksonomia e Bloom-it

<input type="radio"/> Mbajtja mend	Listo, recito, përshkruaj, përkufizo, emërto, përputh, cito, kujto, identifikoj, etiketo, njoh
<input type="radio"/> Të kuptuarit	Përshkruaj, shpjego, parafrazo, rideklaro, jep shembuj, përmbledh, krahaso me të kundërtën, interpreto, diskuto
<input type="radio"/> Zbatimi	Llogarit, parashiko, apliko, zgjidh, ilustrto, përdor, demonstro, përcakto, modelo, realizo, paraqit
<input type="radio"/> Analizimi	Klasifiko, zbërthe, kategorizo, analizo, krijo diagram, kritiko, thjeshtëso, bëj asocim
<input checked="" type="checkbox"/> Vlerësimi	Zgjedh, mbështet, ndërlihd, përcakto, mbrojtë, gjyko, vlerëso, krahaso, krahaso me të kundërtën, argumento, arsyeto, mbështet, bind, përzgjedh, vlerëso
<input checked="" type="checkbox"/> Krijimi	Dizajno, formulo, ndërto, zbuloj, krijo, kompono, nxjerr kuptim, modifikoj, zhvillo

### Kompetencat

<input checked="" type="checkbox"/> Mendimi kritik	Të gjitha nën-shkathtësitë
<input checked="" type="checkbox"/> Mendimi kreativ	Të gjitha nën-shkathtësitë
<input checked="" type="checkbox"/> Zgjidhja e problemeve	Të gjitha nën-shkathtësitë
<input checked="" type="checkbox"/> Komunikimi	Të gjitha nën-shkathtësitë
<input checked="" type="checkbox"/> Bashkëveprimi	Të gjitha nën-shkathtësitë
<input checked="" type="checkbox"/> Vet-menaxhimi	Të gjitha nën-shkathtësitë



# Kartolinat me pyetje dhe përgjigje të shpejta

## PËRSHKRIMI:

Nxënësit përdorin kartolina me pyetje dhe përgjigje për të lëvizur nëpër dhomë dhe për të bërë pyetje dhe për t'u përgjigjur pyetjeve të nxënësve të tjerë për të mësuar më shumë rreth lëndës.

## QËLLIMI:

Kjo është një strategji që u ndihmon nxënësve që:

- Mësojnë ose praktikojnë fjalorin
- Diskutojnë çështje ose koncepte, bazuar në fakte
- Mësojnë fakte të reja



### Grupimet:

Grupe me nga 4 persona



### Niveli i Klasës:

4+



### Koha:

30 – 60 minuta



### Kur prezantohen më së miri në njësinë mësimore:

Në mes



## SHITESË:

Mësimdhënësi u jep kartolinat dhe nxënësit i shkruajnë vetë pyetjet dhe përgjigjet.

## UDHËZIMET

- 1 Mësimdhënësi krijon kartolina me pyetje në njërën anë dhe përgjigjen në anën tjetër. Kartolina mund të përmbajë gjithashtu disa pyetje dhe përgjigje.
- 2 Secili nxënës merr një kartolinë dhe lexon të dyja anët për të parë nëse e kuptojnë pyetjen dhe përgjigjen.
- 3 Nxënësit lëvizin përreth për të gjetur një tjetër nxënës për të punuar me të. Ata parashtrajnë pyetjet me radhë dhe bëjnë kontrollimin e pyetjeve dhe përgjigjeve në kartolinë.
- 4 Në fund, nxënësit mund të regjistrojnë në fletoret e tyre ato që kanë mësuar.

## KOMPETENCAT DHE NËN-KOMPETENCAT E PËRKRAHURA

### Taksonomia e Bloom-it

- Mbajtja mend** Listo, recito, përshkruaj, përkufizo, emërto, përputh, cito, kujto, identifikoj, etiketo, njoh
- Të kuptuarit** Përshkruaj, shpjego, parafrazo, rideklaro, jep shembuj, përmbledh, krahaso me të kundërtën, interpreto, diskuto
- Zbatimi** Llogarit, parashiko, apliko, zgjidh, ilustron, përdor, demonstro, përcakto, modelo, realizo, paraqit
- Analizimi** Klasifiko, zbërthe, kategorizo, analizo, krijo diagram, kritikoj, thjeshtëso, bëj asociim
- Vlerësimi** Zgjedh, mbështet, ndërlidh, përcakto, mbrojtë, gjyko, vlerëso, krahaso, krahaso me të kundërtën, argumento, arsyeto, mbështet, bind, përzgjedh, vlerëso
- Krijimi** Dizajno, formulo, ndërto, zbulo, krijo, kompono, nxjerr kuptim, modifiko, zhvillo

### Kompetencat

- Mendimi kritik** Bëni pyetje kritike / Mblidhni, analizoni dhe vlerësoni besueshmërinë e informatave / nxirrni përfundimin dhe vlerësimin
- Mendimi kreativ**
- Zgjidhja e problemeve**
- Komunikimi** Të dëgjuarit dhe të folurit aktiv / Negociimi dhe ndikimi
- Bashkëveprimi**
- Vet-menaxhimi**

# Tabela e zgjedhjes

## PËRSHKRIMI:

Tabela e zgjedhjes është një tabelë ose një rrjet me detyra të ndryshme në të cilat nxënësit zgjedhin aktivitetet ose detyrat që ata duan t'i bëjnë. Të gjitha detyrat ndërlidhen me një ide ose koncept të madh.

## QËLLIMI:

Nxënësit zgjedhin aktivitetet që duan të bëjnë dhe kjo inkurajon motivimin, pavarësinë dhe vetë-menaxhimin.



### Grupimet:

Puna individuale, në çift apo grupe



### Niveli i Klasës:

4+



### Koha:

E gjithë njësia mësimore



Kur prezantohen më së miri në njësinë mësimore:

Në fillim



## SHTESË:

Nxënësit krijojnë tabela të zgjedhjes për nxënësit e tjerë në klasë.

## UDHËZIMET

- 1 Mësimdhënësi krijon tabelën e zgjedhjes me detyra të ndryshme. Këto ndërlidhen me idenë ose konceptin e madh të njësisë mësimore. Detyrat zakonisht janë të hapura. Për shembull, shkruani një poezi ose krijoni një poster ose bëni një lojë me role.
- 2 Nxënësit mund të punojnë në grupe të ndryshme (zakonisht në çift ose grupe me nga katër veta), por disa nxënës mund të zgjedhin të punojnë vetë.
- 3 Mësimdhënësi jep një afat kohor për detyrën (së paku 30 deri në 60 minuta).
- 4 Tableta e zgjedhjes mund të ketë aktivitete më të shkurtra dhe nxënësit punojnë në një seri mësimesh për të përfunduar të gjitha aktivitetet.
- 5 Ju lutemi vini re, se rezultatet varen shumë nga detyrat ose aktivitetet në tabelën e zgjedhjes.

## KOMPETENCAT DHE NËN-KOMPETENCAT E PËRKRAHURA

### Taksonomia e Bloom-it

- Mbajtja mend** Listo, recito, përshkruaj, përkufizo, emërto, përputh, cito, kujto, identifikoj, etiketo, njoh
- Të kuptuarit** Përshkruaj, shpjego, parafrazo, rideklaro, jep shembuj, përmbledh, krahaso me të kundërtën, interpreto, diskuto
- Zbatimi** Llogarit, parashiko, apliko, zgjidh, ilustru, përdor, demonstro, përcakto, modelo, realizo, paraqit
- Analizimi** Klasifiko, zbërthe, kategorizo, analizo, krijo diagram, kritiko, thjeshtëso, bëj asociim
- Vlerësimi** Zgjedh, mbështet, ndërlidh, përcakto, mbrojtë, gjyko, vlerëso, krahaso, krahaso me të kundërtën, argumento, arsyeto, mbështet, bind, përzgjedh, vlerëso
- Krijimi** Dizajno, formulo, ndërto, zbulu, krijo, kompono, nxjerr kuptim, modifiko, zhvillo

### Kompetencat

- Mendimi kritik**
- Mendimi kreativ**
- Zgjidhja e problemeve**
- Komunikimi**
- Bashkëveprimi**
- Vetë-menaxhimi** Të qenit i njohur me vetveten / Të qenit i përgjegjshëm / vendosja dhe arritja e synimeve / njohimi dhe menaxhimi emocional / menaxhimi i kohës

# PMI (Plus, Minus, Interessant)

## PËRSHKRIMI:

Nxënësit përdorin udhëzime (plus, minus, interesant) për të menduar rreth idesë apo konceptit të madh.

## QËLLIMI:

Kjo strategji e mësimnxënies aktive u ndihmon nxënësve që të:

- Ekzaminojnë gjërat në favor, ato kundër, dhe idetë për një ide ose koncept të madh
- Nxisin të menduarit dhe diskutimin rreth një ideje ose koncepti të madh
- Marrin parasysh këndvështrime të tjera
- Vendosin për këndvështrimin e tyre lidhur me një ide ose çështje.



### Grupimet:

Puna individuale, në çift apo grupe



### Niveli i Klasës:

4+



### Koha:

5 – 10 minuta



### Kur prezantohen më së miri në njësinë mësimore:

Në fillim



## SHTESË:

Nxënësit i përdorin idetë për të shkruar një ese, krijuar një poster, etj, lidhur me idenë e madhe apo konceptin.

## UDHËZIMET

- 1 Mësimdhënësi përgatit një fletë pune për nxënësit me tre kolona me titujt në vijim:
  - Plus (dobi apo përparësi)
  - Minus (mangësi)
  - Interessant (një pikë interesante)
- 2 Nxënësit punojnë në çifte ose grupe të vogla për t'i shkruar idetë për idenë apo konceptin e tyre të madh, dhe në secilën kolonë nxënësit i ndajnë idetë e tyre me njëri tjetrin.

## KOMPETENCAT DHE NËN-KOMPETENCAT E PËRKRAHURA

### Taksonomia e Bloom-it

- Mbajtja mend** Listo, recito, përshkruaj, përkufizo, emërto, përputh, cito, kujto, identifikoj, etiketo, njoh
- Të kuptuarit** Përshkruaj, shpjego, parafrazo, rideklaro, jep shembuj, përmbledh, krahaso me të kundërtën, interpreto, diskuto
- Zbatimi** Llogarit, parashiko, apliko, zgjidh, ilustru, përdor, demonstro, përcakto, modelo, realizo, paraqit
- Analizimi** Klasifiko, zbërthe, kategorizo, analizo, krijo diagram, kritikoj, thjeshtëso, bëj asociim
- Vlerësimi** Zgjedh, mbështet, ndërlidh, përcakto, mbrojtë, gjyko, vlerëso, krahaso, krahaso me të kundërtën, argumentoj, arsyeto, mbështet, bind, përzgjedh, vlerëso
- Krijimi** Dizajno, formulo, ndërto, zbulo, krijo, kompono, nxjerr kuptim, modifiko, zhvillo

### Kompetencat

- Mendimi kritik** Bëni pyetje kritike / Mblidhni, analizoni dhe vlerësoni besueshmërinë e informatave / nxirri përfundime dhe vlerësime
- Mendimi kreativ**
- Zgjidhja e problemeve**
- Komunikimi** Të dëgjuarit dhe të folurit aktiv / Shkathtësitë e komunikimit joverbal / Negocimi dhe ndikimi
- Bashkëveprimi**
- Vet-menaxhimi**

# Posterat dhe Ecje në Galeri

## PËRSHKRIMI:

Nxënësit krijojnë postera për një ide apo koncept të madh. Posterat vendosen në mur dhe nxënësit i lexojnë posterat për të mësuar më shumë rreth tyre.

## QËLLIMI:

Strategjia e mësimnxënies aktive u ndihmon nxënësve që të:

- Angazhohen në mësimnxënien aktive
- Jenë të motivuar dhe të interesuar në procesin mësimor
- Marrin përgjegjësi për vetë procesin e tyre mësimor



### Grupimet:

Grupe të vogla me nga 4 veta dhe pastaj puna individuale



### Niveli i Klasës:

4+



### Koha:

E gjithë njësia mësimore



Kur prezantohen më së miri në njësinë mësimore:

Në fillim



## SHTESË:

Nxënësit mund t'u japin informata kthyesë njëri tjetrit duke përdorur "Dy Yje dhe një Dëshirë (Që vijon në faqen tjetër).

## UDHËZIMET

- 1 Mësimdhënësi krijon një detyrë në të cilën nxënësit punojnë së bashku dhe prezantojnë idetë e tyre në një fletë letre të tabelës.
- 2 Nxënësit e plotësojnë posterin e tyre brenda një afati kohor dhe pastaj e vendosin atë në mur.
- 3 Njëri nga nxënësit qëndron me posterin për të ndihmuar në shpjegimin e tij ndërsa nxënësit e tjerë lëvizin për t'i parë të gjitha posterët.
- 4 Nxënësit qëndrojnë me radhë pranë posterit të tyre në mënyrë që secili prej tyre të ketë mundësinë të vizitojë posterat e grupeve të tjera.

## KOMPETENCAT DHE NËN-KOMPETENCAT E PËRKRAHURA

### Taksonomia e Bloom-it

<input type="radio"/> Mbajtja mend	Listo, recito, përshkruaj, përkufizo, emërto, përputh, cito, kujto, identifikoj, etiketo, njoh
<input type="radio"/> Të kuptuarit	Përshkruaj, shpjego, parafrazo, rideklaro, jep shembuj, përmbledh, krahaso me të kundërtën, interpreto, diskuto
<input type="radio"/> Zbatimi	Llogarit, parashiko, apliko, zgjidh, ilustrto, përdor, demonstro, përcakto, modelo, realizo, paraqit
<input type="radio"/> Analizimi	Klasifikoj, zbërthe, kategorizoj, analizo, krijo diagram, kritikoj, thjeshtëso, bëj asocim
<input type="radio"/> Vlerësimi	Zgjedh, mbështet, ndërlidh, përcakto, mbrojtë, gjyko, vlerëso, krahaso, krahaso me të kundërtën, argumentoj, arsyeto, mbështet, bind, përzgjedh, vlerëso
<input checked="" type="radio"/> Krijimi	Dizajno, formuloj, ndërtoj, zbuloj, krijo, komponoj, nxjerr kuptim, modifikoj, zhvillo

### Kompetencat

<input type="radio"/> Mendimi kritik	
<input checked="" type="radio"/> Mendimi kreativ	Parashtrimi i pyetjeve / krijimi i ideve / vënia e ideve në veprim
<input type="radio"/> Zgjidhja e problemeve	
<input checked="" type="radio"/> Komunikimi	Të dëgjuarit dhe të folurit aktiv / shkathtësitë e komunikimit joverbal
<input type="radio"/> Bashkëveprimi	
<input type="radio"/> Vet-menaxhimi	

# Dy Yje dhe një Dëshirë

## PËRSHKRIMI:

Një strategji vlerësimi formues që nxënësit të japin informata kthyesë për njëri-tjetrin në lidhje me punën e tyre.

## QËLLIMI:

Kjo strategji inkurajon vlerësimin konstruktiv të bashkëmoshatarëve ndërmjet nxënësve:

- T'u sigurojë nxënësve aftësitë për të dhënë komente miqësore
- Të zhvillojnë aftësinë për të vlerësuar dhe përmirësuar punën e tyre



Grupimet:  
Individuale



Niveli i Klasës:  
4+



Koha:  
5 – 10 minuta



Kur prezantohen më së miri në  
njësinë mësimore:  
Në fund



## SHTESË:

- 1 Para fillimit, nxënësit mund ta shqyrtojnë vetë punën e tyre duke përdorur metodën.
- 2 Nxënësit mund të bëjnë një listë yjesh dhe dëshirash të pranuar lidhur me punën dhe t'i përdorin këto informata për të përmirësuar draftin e radhës.

## UDHËZIMET

- 1 Nxënësit lexojnë ose shqyrtojnë punën e njëri-tjetrit.
- 2 Nxënësit zgjedhin një pjesë të punës për të dhënë komente.
- 3 Nxënësit shkruajnë në një letër ngjitëse apo në një letër të thjeshtë dy gjëra që atyre u pëlqejnë (dy yje) për punën dhe një fushë për përmirësim (një dëshirë) që ata mendojnë se do ta bënte punën më të mirë. Ata i ngjesin këto informata kthyesë mbi punën që po e shqyrtojnë.
- 4 Nxënësit pastaj kthehen në dhomën e tyre të punës për të lexuar reagimet e marra nga të tjerët.
- 5 Nxënësit përmirësojnë punën e tyre bazuar në informatat kthyesë.
- 6 P.sh, duke rishikuar një tregim – Më pëlqejnë idetë në tregim; Më pëlqente mbarimi (dy yje). Ju lutemi përshkruani personazhin kryesor në më shumë detaje (dëshirë).

## KOMPETENCAT DHE NËN-KOMPETENCAT E PËRKRAHURA

### Taksonomia e Bloom-it

- Mbajtja mend** Listo, recito, përshkruaj, përkufizo, emërto, përputh, cito, kujto, identifikoj, etiketo, njoh
- Të kuptuarit** Përshkruaj, shpjego, parafrazo, rideklaro, jep shembuj, përmbledh, krahaso me të kundërtën, interpreto, diskuto
- Zbatimi** Llogarit, parashiko, apliko, zgjidh, ilustrto, përdor, demonstro, përcakto, modelo, realizo, paraqit
- Analizimi** Klasifiko, zbërthe, kategorizo, analizo, krijo diagram, kritikoj, thjeshtëso, bëj asocim
- Vlerësimi** Zgjedh, mbështet, ndërlihdh, përcakto, mbrojtë, gjyko, vlerëso, krahaso, krahaso me të kundërtën, argumento, arsyeto, mbështet, bind, përzgjedh, vlerëso
- Krijimi** Dizajno, formulo, ndërto, zbulo, krijo, kompono, nxjerr kuptim, modifikoj, zhvillo

### Kompetencat

- Mendimi kritik** Parashtroni pyetje kritike / nxirrni përfundimin dhe vlerësimin
- Mendimi kreativ**
- Zgjidhja e problemeve**
- Komunikimi** Të dëgjuarit dhe të folurit aktiv
- Bashkëveprimi**
- Vet-menaxhimi**

# Fakti apo Mendimi

## PËRSHKRIMI:

Nxënësit punojnë në grupe të vogla për të vendosur nëse formulimet janë fakte apo mendime.

## QËLLIMI:

Kjo metodë u kërkon nxënësve që të:

- Vendosin nëse diçka është fakt apo vetëm një mendim
- Dallojnë faktin nga mendimi mbi bazën e provave
- Mësojnë nga situatat ku mund të mos ketë përgjigje të qartë



### Grupimet:

Grupe me nga 4 persona



### Niveli i Klasës:

6+



### Koha:

20 – 30 minuta



Kur prezantohen më së miri në njësinë mësimore:

Në mes



## SHTESË:

Nxënësit i shkruajnë formulimet dhe i japin grupit tjetër për të diskutuar.

## UDHËZIMET

- 1 Para njësisë mësimore, mësimpldhënësi përgatit një numër formulimesh lidhur me një çështje.
- 2 Mësimpldhënësi i jep secilit grup një numër formulimesh lidhur me një çështje të caktuar.
- 3 Grupi përmes diskutimit vendos nëse formulimet janë fakte apo mendime.
- 4 Nxënësit i shkruajnë arsyet për zgjedhjen e bërë nga ta për prezantim para klasës
- 5 Në diskutimin në klasë, nxënësit ndajnë idetë e tyre lidhur me:
  - Si kanë ardhur deri te vendimi
  - A ka pasur shumëllojshmëri mendimesh?
  - Si është arritur konsensusi?

## KOMPETENCAT DHE NËN-KOMPETENCAT E PËRKRAHURA

### Taksonomia e Bloom-it

- Mbajtja mend**
  - ↳ Listo, recito, përshkruaj, përkufizo, emërto, përputh, cito, kujto, identifikoj, etiketo, njoh
- Të kuptuarit**
  - ↳ Përshkruaj, shpjego, parafrazo, rideklaro, jep shembuj, përmbledh, krahaso me të kundërtën, interpreto, diskuto
- Zbatimi**
  - ↳ Llogarit, parashiko, apliko, zgjidh, ilustrto, përdor, demonstro, përcakto, modelo, realizo, paraqit
- Analizimi**
  - ↳ Klasifiko, zbërthe, kategorizo, analizo, krijo diagram, kritikoj, thjeshtëso, bëj asociim
- Vlerësimi**
  - ↳ Zgjedh, mbështet, ndërlidh, përcakto, mbrojtë, gjyko, vlerëso, krahaso, krahaso me të kundërtën, argumento, arsyeto, mbështet, bind, përzgjedh, vlerëso
- Krijimi**
  - ↳ Dizajno, formulo, ndërto, zbuloj, krijo, kompono, nxjerr kuptim, modifiko, zhvillo

### Kompetencat

- Mendimi kritik**
  - ↳ Bëni pyetje kritike / Mblidhni, analizoni dhe vlerësoni besueshmërinë e informatave / nxirrni përfundime dhe vlerësime
- Mendimi kreativ**
  - ↳
- Zgjidhja e problemeve**
  - ↳
- Komunikimi**
  - ↳ Të dëgjuarit dhe të folurit aktiv / negociimi dhe ndikimi
- Bashkëveprimi**
  - ↳ Pjesëmarrja aktive në punën në grup / vendosja dhe ndjekja e rregullave dhe procedurave të grupit / ndarja e informatave dhe burimeve / vlerësimi i punës në grup
- Vet-menaxhimi**
  - ↳

# Shablloni i Zbrazët i Metodës

PËRSHKRIMI:

QËLLIMI:



Grupimet:



Niveli i Klasës:



Koha:



Kur prezantohen më së miri në njësinë mësimore:

SHTESË:

UDHËZIMET

## KOMPETENCAT DHE NËN-KOMPETENCAT E PËRKRAHURA

### Taksonomia e Bloom-it

- Mbajtja mend** Listo, recito, përshkruaj, përkufizo, emërto, përputh, cito, kujto, identifikoj, etiketo, njoh
- Të kuptuarit** Përshkruaj, shpjego, parafrazo, rideklaro, jep shembuj, përmbledh, krahaso me të kundërtën, interpreto, diskuto
- Zbatimi** Llogarit, parashiko, apliko, zgjidh, ilustru, përdor, demonstro, përcakto, modelo, realizo, paraqit
- Analizimi** Klasifiko, zbërthe, kategorizo, analizo, krijo diagram, kritiko, thjeshtëso, bëj asocim
- Vlerësimi** Zgjedh, mbështet, ndërlihdh, përcakto, mbrojtje, gjyko, vlerëso, krahaso, krahaso me të kundërtën, argumento, arsyeto, mbështet, bind, përzgjedh, vlerëso
- Krijimi** Dizajno, formulo, ndërto, zbulo, krijo, kompono, nxjerr kuptim, modifikoj, zhvillo

### Kompetencat

- Mendimi kritik**
- Mendimi kreativ**
- Zgjidhja e problemeve**
- Komunikimi**
- Bashkëveprimi**
- Vet-menaxhimi**











